



LAJME nga FONDACIONI
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË
Tiranë

N.25
Shkurt
2026

Redaksia "ZKM ALBANIA"
Kompleksi Spitalor Universitar
"Zoja e Këshillit të Mirë"
Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë

unikzkm
unikzkm
www.unizkm.al
pr@fzkm.org

ETJE PËR TË DREJTËT

Magjistratët Falkone dhe Borselino

Nga votimi demokratik që u zhvillua në Kampusin ZKM gjatë janarit rezultuan si më të votuarit magjistratët e ndjerë Xhovani Falkone dhe Paolo Borselino, të cilët luftuan me përkushtim sublim realitetin e egër të mafies, realitetin e egër të Cosa Nostra-s që shtrihej me krimet dhe ndikimin e saj deri tek lidhjet me politikën, ekonominë apo grupimet e fshehta subversive.

Për shkak të kësaj lufte pa kompromis ata u vranë! **Xhovani Falkone** lindi në Palermo në vitin 1939, ndërsa **Paolo Borselino** lindi në të njëjtën lagje tetë muaj më vonë, në vitin 1940.

Ata u vranë mizorisht në vitin 1992 duke lënë pas një Itali me më shumë të vërteta mbi të keqen e saj më të madhe.

Ndaj sot ne nderojmë jetët e tyre që bëhen thirrje për të gjithë ata që e duan vendin e tyre të lirë nga mafia.

Të Drejtët nderohen çdo 6 mars për kontributin që kanë dhënë në komunitete të ndryshme.

Por këtë vit ceremonia jonë do të organizohet më datë 11 mars 2026



sepse në po këtë ditë do të shpallet edhe I Drejti i Kopshtit të ngjashëm me ne në Milano të Italisë.

Duke qenë se jehona e Kopshtit të UKZKM ka dale jshtë kufijve të Shqipërisë vendosëm që Të Drejtin ta shpallim në të njëjtën ditë me qytetin e Milanos si shenjë e një rrjeti të madh që vlerëson kontributin njerëzor.

Kopshti i të Drejtëve në Kampusin e Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" u inaugurua në vitin 2024 për të kremtuar njëzet vjetorin e themelimit të Universitetit ZKM.

Ky kopsht është i vetmi në Shqipëri i ndërtuar me këtë motivacion.

MESAZHI I ATIT TË SHENJTË PËR DITËN BOTËRORE TË TË SËMURËVE

vijon në faqen 14



Të dashur vëllezër dhe motra!

Kam dashur të ripropozoj imazhin e Samaritanit të Mirë gjithmonë aktual dhe të nevojshëm për të rizbuluar bukurinë e bamirësisë dhe dimensionin shoqëror të dhembshurisë për të tërhequr vëmendjen për ata në nevojë dhe ata që vuajnë siç janë të sëmurët.



Më 18 shkurt 2026 në prag të nisjes së një takimi ndërkombëtar Ministri italian i Punëve të Jashtme **Antonio Tajani** takoi Presidentin e Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë **Fr. Ruggero Valentini**.

Gjatë takimit Ministri kërkoi të informohej mbi aktivitetet e Fondacionit në sektorët shëndetësorë dhe universitarë duke shprehur vlerësimin për bashkëpunimin e nisur me Universitetet italiane.

Presidenti Valentini po ashtu nënvizoi rëndësinë e sinergjisë me Italinë si një bashkëpunim veçanërisht i vlerësuar në Shqipëri dhe i konsideruar strategjik për zhvillimin e projekteve të përbashkëta në fushën e edukimit dhe shëndetësisë.

PARTNERITET I SË ARDHMES

Spitali Bambino Gesù i Romës dhe Spitali Katolik i Tiranës

Një ditë e rëndësishme u shënua gjatë janarit për **Spitalin Katolik Zoja e Këshillit të Mirë të Tiranës** që zyrtarizoi një bashkëpunim të ri me **Spitalin Pediatrik "Bambino Gesù"** të Romës, i cili synon forcimin e sektorit pediatrik përmes projekteve inovative, kërkimit të përbashkët dhe shkëmbimit të ekspertizës, me qëllim përmirësimin



e kujdesit ndaj pacientëve të vegjël dhe formimin e profesionistëve të ardhshëm.

Modeli i bashkëpunimit u prezantua gjatë një ceremonie ku ishte e pranishme **Ministrja e Shëndetësisë së Shqipërisë Znj. Evis Sala**, Zv. Ministri i Shëndetësisë së Italisë **Z. Marçelo Xhemato**, në lidhje të drejtëpërdrejtë Presidenti i Spitalit Bambino Gesù të Romës Prof. Tiziano Onesti, Drejtori Mjekësor i kësaj qendre të njohur botërisht z. Massimiliano Raponi dhe Përgjegjësi për Marrëdhëniet Ndërkombëtare z. Alessandro Cristaldi.

Ministrja Evis Sala shprehu vlerësimet e saj për këtë pol të



rëndësishëm shëndetësor si Spitali Katolik i Tiranës që tashmë pasurohet edhe me përvojën e bashkëpunimit me Spitalin e Papës që ofron në një vit kalendarik qindra mijëra shërbime mjekësore në të gjithë botën për fëmijët.

Kjo është një marrëveshje për të ardhmen, tha Z. Cristaldi gjatë fjalës prezantuese, duke sjellë në kujtesë të të pranishmëve fjalët e Papa Françeskut se mund të ketë sëmundje të pashërueshme, por të kujdesesh për fëmijët është gjithmonë e mundur.

Audienca mikpriti adresimet e Dekanes së Fakultetit të Mjekësisë pranë UKZKM Dr. Anila Godo dhe fjalën inkurajuese të Prof. Tiziano Onesti.

Ceremonia u mbyll me nënshkrimin e kortezi së mbi marrëveshjen e re me Spitalin Bambino Gesù për një "Qendër të Zhvillimit të Fëmijës" ndërsa Presidenti i Fondacionit ZKM fr. Ruggero Valentini nderoi me Medaljonin e Nënë Terezës zv. Ministrin italian **Z. Marçelo Xhemato**.



Ky i fundit la përshtypjet e tij me një shënim të gjatë në librin e miqve të Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë.



AKREDITIMI I SPITALIT KATOLIK

"Në respekt të kuadrit ligjor që rregullon shërbimin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë **Spitali Katolik Zoja e Këshillit të Mirë** aplikoi dhe përfundoi me sukses procesin e akreditimit institucional sipas të cilit mori edhe certifikatën përkatëse të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë me afat deri më 9 Dhjetor 2030.

Çfarë është akreditimi i strukturave shëndetësore?

Ky proces përfaqëson shumë më tepër sesa thjesht një detyrim burokratik: ai është një objektiv strategjik për dokumentimin dhe garantimin e cilësisë si pjesë e sistemit shëndetësor. Miratimi dhe plotësimi i standardeve në ofrimin e kujdesit shëndetësor do të thotë në radhë të parë vendosja e **pacientit** në qendër të vëmendjes duke siguruar që çdo protokoll mjekësor të bazohet në evidencat më të mira shkencore. Për **profesionistët** akreditimi nënkupton të punuarit në një mjedis të sigurt ku procedurat dhe ekzaminimet reduktojnë rrezikun klinik dhe vlerësojnë punën e tyre në ekip.

Për **Spitalin Katolik** akreditimi përfaqëson një investim strategjik që forcon besimin e pacientëve dhe na jap cilësimin si ofrues të kualifikuar që plotëson ofertën e Sistemit Shëndetësor Publik dhe përbën një faktor dallues cilësie dhe besueshmërie mes strukturave shëndetësore private në vend.

Deklarata e Drejtorit Shëndetësor, Fabjan Çenko"



ERASMUS+

ZEMRA NË RREZIK

Kërkim dhe inovacion kundër dislipidemisë

Nga data 26 deri më 30 janar 2026 Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" pati kënaqësinë të mirëpresë Prof. Ilaria Zanotti nga Universiteti i Parmës gjatë një mobiliteti për mësimdhënie në kuadër të programit Erasmus+ KA171 për studentët e Programit të Studimit në Farmaci. Gjatë leksioneve dhe seminareve Prof. Zanotti trajtoi tema me rëndësi të madhe shkencore dhe arsimore duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të sëmundjeve kardiovaskulare në shëndetin global dhe përcaktimit të rrezikut kardiovaskular, strategjive parandaluese të bazuara te ushqyerja dhe suplementet ushqimorë, barnave të reja të miratuara për menaxhimin e dislipidemisë si dhe kërkimeve shkencore aktuale mbi targetet inovative për zhvillimin e terapive të ardhshme farmaceutike.



Mobiliteti përfshiu gjithashtu takime institucionale dhe shkëmbime mendimesh me Departamentet e Fakultetit të Farmacisë duke kontribuar në forcimin e bashkëpunimit akademik dhe promovimin e ndërkombëtarizimit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

MES ARRITJEVE DHE SFIDAVE TË REJA

20 Vjet
2005-2025

FAKULTETI I FARMACISË

Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë mbledhi miq e partnerë të shumtë më 28 janar për të kremtuar një ditë krenarie siç është përvjetori i 20-të i Fakultetit të Farmacisë në Universitetin Katolik të Tiranës. Ky



moment që përfaqëson edhe një arritje të rëndësishme për botën universitare në Shqipëri u përshëndet me përgëzime nga të ftuar si Shkëlqesia e Tij Ambasadori Italian Marco Alberti, i nderuari Zv. Sekretari i Shtetit për Shëndetësinë në Republikën e Italisë Dr. Marcello Gemmato, Davide Rogai President i Konfindustrisë së Shqipërisë dhe Z. Dëfrim Goma President i Urdhrit të Farmacistëve. Të ftuarit u mikpritën nga fr. Ruggero

Valentini Presidenti i Fondacionit ZKM, Rektori i UKZKM Prof. Leonardo Palombi dhe Dekani, Prof. Roberto Perrone. Dy dekada të Fakultetit të Farmacisë pranë UKZKM shënojnë edhe një moment me rëndësi të madhe për kujdesin shëndetësor sepse siç tha Presidenti Valentini në fund të fundit qëllimi është të mbrojmë dhe t'i shërbejmë jetës së njeriut siç dikur At' Luigji Monti bënte duke hedhur hapat e parë të një farmaceutike modeste.



Dekani C. De Giuli Morghen dhe R. Perrone u nderuan gjatë ngjarjes për 20-vjetorin e Farmacisë

Duke marrë fjalën në konferencë Ambasadori Alberti tha se Italia nuk është e famshme vetëm për ushqimin, modën, kulturën dhe artin, por është vendi i parë në tregun farmaceutik evropian dhe në kërkimin shkencor në këtë fushë. Ai përgëzoi inaugurimin e dy laboratorëve kërkimorë modernë të Fakultetit të Farmacisë në Kampusin ZKM duke marrë pjesë edhe në ceremoninë e prerjes së shiritit dhe bekimit të tyre nga Padre Paschal.

INAUGURIMI I LABORATORËVE TË KËRKIMIT



Studentëve të Universitetit Katolik të Tiranës u shtohen të tjera hapësira studimore dhe eksperimentale siç janë laboratoritë e virologjisë qelizore dhe molekulare dhe laboratoritë e kimisë dhe analizave farmaceutike.

Çfarë kremtojmë me këtë 20 vjetor nuk është thjesht angazhimi, përkushtimi, kërkimi farmaceutik dhe inovacioni, por edhe rritja e arsimimit të brezave të kualifikuar me standardet evropiane të të rinjve që sot shërbejnë në Shqipëri dhe Evropë.



Ky është një udhëtim bashkëpunimesh të rëndësishme, fillimisht me Universitetin e Milanos pastaj me Universitetin e Barit. Disa nga profesionistët e talentuar që u diplomuan në UKZKM u bënë pjesë e ceremonive festive në kampusin tonë.

Të rinjtë që studiojnë në UKZKM përfaqësojnë profesionistë kompetentë dhe të apasionuar që janë të gatshëm për të kontribuar në përparimin e shkencës dhe kujdesit shëndetësor në Shqipëri dhe më gjerë.



JEPET NË SHQIPËRI ÇMIMI PËR PAQEN 2026

Më 11 mars në Universitetin Katolik të Tiranës do të mbahet edicioni i parë i iniciativës së promovuar dhe mbështetur nga Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë me Qendrën Europiane të Shkencës për Paqen

Qendra Europiane e Shkencës për Paqe, Integrim dhe Bashkëpunim organizon për herë të parë në Shqipëri nismën Çmimi i Paqes, një ngjarje që mbështetet në mënyrë domethënëse nga Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë.

Eventi do të mbahet më 11 mars 2026 prej orës 10.00 të mëngjesit në Aula Magna në Universitetin Katolik të Tiranës në bashkëpunim edhe me Observatorin Ballkan-Kaukaz-Transevropë / Qendrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar (OBCT/CCI).

Çmimi i Paqes u kushtohet individëve dhe organizatave që janë dalluar për përkushtimin e tyre ndaj paqes me fokus të veçantë në rajonin e Ballkanit. Ideja për dhënien e një Çmimi Paqeje u konkretizua që në maj të vitit 2025 kur u prezantua zyrtarisht nisma e mbështetur nga FZKM dhe e koordinuar nga Qendra Evropiane për Studimet e Paqes, Integritetit dhe Bashkëpunimit (CESPIC).



Një juri ndërkombëtare e përbërë nga ekspertë të njohur që vijnë nga vendet e Evropës Juglindore, Ballkani dhe Shqipëria kanë vlerësuar që këtë vit Çmimi i Paqes t'u jepet:

Nihad Suljić, me motivacionin për angazhimin e tij të vazhdueshëm humanitar dhe kontributin e tij në paqen sociale

Projektit "Libra të Përbashkët të Historisë" me motivacionin për rolin e tij afatgjatë edukativ në

promovimin e mirëkuptimit dhe pajtimit të ndërsjellë.

Mëngjesin e 11 marsit çmimi do të jepet në ceremoninë publike të rastit ku do të ketë të ftuar të shumtë.

Sesioni ceremonial do të drejtohet nga Profesor **Raul Caruso** Drejtor i Qendrës CESPIC.

DILEMAT E SOTME TË SHOQËRIVE MODERNE

Kulturë apo konsumizëm



Në një nga sallat e leksioneve në UKZKM u mbajt Konferenca ndërkombëtare me temë “Politically correct, cancel culture dhe identiteti: cilët skenarë?” e organizuar nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale në Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” dhe nga Departamenti i Shkencave Juridike i Universitetit të Studimeve të Pizës.



solli në vëmendje faktin se ky takim mbahet në të njëjtën kohë me punimet e takimit të Davos duke aktualizuar zhvillimet historike sot në botë. Ndërsa Prof. Antonello de Oto nga universiteti i Bolonjës tha se ishte surprizuar nga Tirana që gjeti pas 35 vitesh, kur ai e kishte vizituar për herë të parë.

Tirana tha ai ka bashkuar modernitetin me historinë e dikurshme të komunizmit dhe ky është një shembull i transformimit pa përjashtuar askënd.

Po kështu Prof. Mario Ferrante u tregoi të rinjve në sallë pas një fjale të sistemuar në shumë shembuj historikë se duhet të mos druheni të flasim për kulturën tonë të vlerave njerëzore dhe se çfarë besimi shpirtëror na ka dhënë ndër shekuj. Stefano Foglia nga Universiteti i Pizës solli ndikimin e simbolikave si vlerë edukuese për njerëzimin duke iu referuar edhe rastit të Shqipërisë me historinë para viteve '90.

Konferenca shënoi fjalime edhe nga Znj. Desiree Pappalardo, Z. Daniele Garofalo dhe avokat Giuliano Boschetti.

Takimi u ndoq nga ZV. Rektori i UKZKM Prof. Edmond Hajdëri profesorë të universitetit tonë, studentë dhe të ftuar të tjerë.

Konferenca erdhi për një audience pa moshë si një dritare komunikimi nga lektorë dhe profesorë të njohur ndërkombëtarisht për studentët tanë dhe të ftuar të shumtë.

Presidenti i FZKM fr. Ruggero Valentini ndërsa përshëndeti konferencën tha se kjo temë e tërhoqi që në fillim sepse ka ndikim në jetën tonë. Si njeri i zakonshëm, tha ai, mund të them se sot kemi një rezistencë të kulturës përballë konsumizmit dhe ka një realitet social që është shumë dinamik.

Ndaj ai u solli të pranishmëve në vëmendje shembullin tonë në UKZKM me zgjedhjen e Të Drejtës duke manifestuar të mirën. Duhet të kujtojmë, tha fr. Ruggero Valentini, atë që jeta na ka dhënë, të mirën dhe vlerën e jetës. Zv. Dekani i Fakultetit të Ekonomisë pranë UKZKM Klodian Muço duke moderuar seminarin



BËHU I DUKSHËM!

Newsletter-i ZKM Albania
u dërgohet më shumë se
10.000 kontakteve.

**REZervo këtë
HAPËSIRË REKLAMUESE**

Për detaje kontakto
redaksinë e ZKM ALBANIA opr@fzkm.org

PARQET DHE HAPËSIRAT E PËRBASHKËTA

Jo vetëm arkitekturë!

Sa herë ju ka ndodhur të ndiqni një projekt arkitekturor që nga momenti i parë i skicimit ose qëkur lapsi prek mbi tabakët e bardhë të letrave?



Mbase jo shpesh, ndaj një grup studentësh të Arkitekturës pranë Universitetit Katolik të Tiranës "Zoja e Këshillit të Mirë" ishin më 10 shkurt prej mëngjesit pranë hapësirës krijuese që njihet si "Syri i Qiellit" në Parkun e Madh të Liqenit Artificial të Tiranës.

Studentët projektuan individualisht mbi temën "Një vend lutjeje pranë Liqenit të Tiranës". Ngjarja studentore dhe krijuese u mbështet nga Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, e cila mbështet inisiativa që pasurojnë jetën urbane dhe zhvillimore të kryeqytetit. Të udhëhequr nga lektorët **Ph.D Ark. Roberto Bosi** dhe **PhD. Ark. Klenisa Galica** ky aktivitet synon të krijojë një mjedis studimor, gjatë të cilit të rinjtë angazhohen në analiza konceptuale, zhvillim idesh dhe formulim zgjidhjesh arkitektonike mbi tema të përcaktuara kërkimore. Duke u dhënë studentëve të UKZKM një hapësirë sa krijuese aq edhe studimore Agjencia e Parqeve në Bashkinë e Tiranës kontribuon edhe në pasurimin e rolit medietues të hapësirave tona ndaj publikut duke afruar njerëzit me natyrën dhe duke nxitur botën akademike siç është ky rast të besojë në partneritete të dobishme për studentët.

Të rinjtë do të kenë mundësi të integrojnë njohuritë teorike me praktikën profesionale të projektimit.



Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" aktivizon për vitin akademik 2025–2026 Programin e Doktoraturës në: **"Arkitektura mesdhetare: Projektimi, Njohja dhe Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore"**, një program formimi ndërkombëtar me bashkëudhëheqje (co-tutela) me Universitetin e Studimeve të Firences (Departamenti i Arkitekturës).

Ky program u mundëson doktorantëve, përmes mobilitetit dhe mbikëqyrjes së përbashkët, të zhvillojnë kërkimet e tyre në periudha të alternuara në të dy institucionet dhe, në përfundim të ciklit të studimeve, me një mbrojtje të vetme të tezës, të përfitojnë një diplomë të dyfishtë Doktor i Shkencave.



E ARDHMJA NË DUART TUAJA

ALUMNI DHE KARRIERA

Zyra e Orientimit të Karrierës konfirmon edhe për vitin 2026 angazhimin e saj për të mbështetur studentët që diplomohen dhe të diplomuarit duke forcuar dialogun midis botës akademike dhe asaj profesionale

Universiteti vazhdon të promovojë mundësi për komunitetin e tij akademik për t'u takuar dhe për të ndarë përvoja duke ftuar të gjithë të diplomuarit të marrin pjesë në evente institucionale siç ishte ALUMNI REUNION dhe Ceremonia e Ndarjes së Çmimit për "Tezën më të Mirë".

Këto janë raste të çmuara për të forcuar ndjenjën e përkatësisë dhe për të nxjerrë në pah rrugën drejt ekselencës. Në veçanti në prag të Ceremonisë së Ndarjes së Çmimit për "Tezën më të Mirë" për vitin 2026 studentët e viteve të fundit të çdo Programi Studimi janë të ftuar të përkushtohen maksimalisht në shkrimin e tezës së tyre pasi të gjitha tezat e mbrojtura gjatë vitit 2026 do të jenë kandidatë për këtë çmim. Së fundmi me qëllim ruajtjen e një kontakti të vazhdueshëm me të diplomuarit dhe vlerësimin e sukseseve të tyre profesionale në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar duke nisur nga ky vit newsletter-i universitar do t'i kushtojë një hapësirë

të veçantë Alumni-t. Zyra e Orientimit të Karrierës do të kontaktojë dhe do të përzgjedhë disa të diplomuar që do të jenë protagonistë të këtij sekioni duke promovuar rrugëtimin e tyre profesional.

Në të njëjtën kohë të gjithë të diplomuarit janë të ftuar të ndajnë përvojën dhe rrugëtimin e tyre profesional duke shkruar në adresën placement@unizkm.al. Jo vetëm tregojmë përvojat më të mira të suksesit, por edhe evidentojmë komunitetin tonë akademik në mbarë botën.

Universiteti Katolik
Zoja e Këshillit të Mirë
Tiranë

si dhe duke krijuar mundësi konkrete për takime, rritje profesionale dhe integrim në tregun e punës.

Në kuadër të marrëveshjeve të promovuara nga kjo Zyrë viti 2026 nis me tre marrëveshje të reja bashkëpunimi në fushat e Arkitekturës, Stomatologjisë dhe Ekonomisë me kompanitë XLAM, Excellentis dhe PricewaterhouseCoopers (PwC). Këto bashkëpunime paraqesin një hap të rëndësishëm në konsolidimin e marrëdhënieve mes Universitetit dhe kompanive duke ofruar perspektiva të reja arsimore dhe profesionale për studentët dhe të diplomuarit tanë. Paralelisht

Work & Study

18 Shkurt - 25 Mars 2026

Eja dhe zbulo nga afër përvojën universitare që vetëm Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" të ofron.

Njihuni me programet tona të studimit, mundësitë për bursa studimi dhe takohu me studentë, pedagogë dhe koordinatore, të gatshëm t'i përgjigjen çdo pyetjeje.



Panairi do të ndalet në të gjithë Shqipërinë. Së shpejti "Zoja" do të vijë edhe në qytetin tënd – të presim!

E MARTA E STUDENTËVE

Të kujtojmë për të kuptuar,
të kujtojmë për të vepruar




E Marta e Studentëve kështu e kemi quajtur takimin e të rinjve brenda komunitetit të tyre. Kjo ditë është hapësirë për reflektim ndaj kohëve që kalojmë për të ndarë mendime e vlerësime mbi shqetësimet shoqërore dhe në përpjekje për të përmirësuar qasjen tonë qytetare dhe evropiane rinore.

Por e marta e fundit e janarit përkon këtë herë edhe me Ditën e Përkujtimit të Holokaustit si një moment ndalese e frymëmarrjeje të thellë për ndërgjegjen njerëzore.

Nga këtu na lindën disa pyetje që do t'i ndajmë bashkë më 27 janar në përpjekje për përgjigje. Si e sjellim në shoqëri kujtesën tonë? Si mund t'a stërvisim atë për të mësuar më mirë çfarë studiojmë në auditore?

Si përshtatemi me të shkuarën?

Studentët do t'u japin zë mendimeve të tyre, ndaj jemi në këtë hapësirë çdo fund muaji.



SUPERDESIGN, ITALIAN RADICAL DESIGN

Në Piramidën e Tiranës u shfaq filmi "Superdesign. Italian Radical Design" prezantimi i të cilit u bë nga Francesca Molteni dhe Maria Cristina Didero.

Aktiviteti u organizua nga Departamenti i Arkitekturës i Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" në bashkëpunim me Institutin Italian të Kulturës në Tiranë.



Filmi rrëfen përmes 19 protagonistëve historinë dhe trashëgiminë e Lëvizjes Radikale Italiane duke na kthyer në mesin e viteve '60 që ishte një periudhë ndryshimesh të thella dhe "turbulence pozitive" edhe në art. Përmes veprave dhe idealeve të arkitektëve, dizajnuesve dhe kuratorëve filmi "Superdesign. Italian Radical Design" tregoi se ëndrrat, utopitë dhe pasionet e lëvizjes janë ende të gjalla edhe sot.

GJITHÇKA QË NDODH TANI NA PREK TË GJITHËVE

**Kujtesa na ndihmon të kuptojmë të kaluarën
ndërsa përgjegjësia na thërret
të veprojmë në të tashmen.**

Është detyra jonë të shprehim mirënjohjen në mënyrë që kujtesa e së mirës të mos humbasë dhe të mbetet në histori jo vetëm si një shembull moral për t'ja transmetuar brezave të ardhshëm sepse në çdo epokë individët do të thirren të bëjnë zgjedhje.

Zbulimi i të Drejtëve na mëson të dallojmë, të mos përgjithësojmë, të zbulojmë përsëri njerëzit e virtytshëm edhe në radhët e armiqve... për të rikthyer besimin në botë, për të mësuar të mos urrejmë dhe të fillojmë përsëri nga e para. Këto mësimë janë

Pas Holokaustit ideja e Të Drejtëve u harrua me të kaluarën sikur njerëzimit nuk i duhej më të vendoste midis së Mirës dhe së Keqes në çdo brez duke krijuar një perceptim të sigurt për të ardhmen që shmangte përgjegjësitë e individëve dhe kombeve.

Për këtë arsye me krijimin e më shumë se 300 Kopshteve të Të Drejtëve nga Amerika Latine, Afrika e deri në Lindjen e Mesme ne kemi ringjallur konceptin e Të Drejtëve për të treguar se zgjedhjet etike janë gjithmonë të lidhura me të tashmen dhe me çdo krizë, mizori masive apo luftë.

Kujtesa lidhet me kuptimin e së kaluarës ndërsa përgjegjësia është gjithmonë e lidhur me të tashmen.

Nuk mund të jesh kurrë përgjegjës për atë që ka ndodhur, por vetëm për atë që ndodh tani.

Kjo është arsyeja pse të vepruarit si i Drejtë është një mënyrë që lidhet me të tashmen, me një perceptim jo komod të historisë që kemi menduar se nuk do të përsëritej më. Por në të vërtetë kemi mbetur të befasuar dhe të zhgënjyer nga

shumë të vlefshme për botën e sotme ku kriza shkakton urrejtje të përgjithshme që godet popuj të tërë.

Të Drejtët janë shfaqur në çdo gjenocid apo mizori masive që nga Holokausti i Hebrenjve të shfarosja e armenëve, në Ruanda, Kamboxhia, Srebrenicë e deri në ditët e sotme.



Gabriele Nissim
nga

"Themelues dhe President i Gariwo – Gardens of the Righteous Worldwide, me seli në Milano."

Në Lojërat Olimpike Dimërore Milano-Cortina 2026 atleti ukrainas Vladyslav Heraskevych vendosi në helmetën e tij fotografitë e disa sportistëve të vrarë gjatë pushtimit rus në Ukrainë. Për këtë arsye, sipas rregullores ai u skualifikua.

MARS, MUAJI I TË DREJTËVE

Katër takime të hapura për të gjithë

Fondacioni ZKM propozon disa iniciativa mbi temën e "Të Drejtëve", të cilët kanë qenë njerëz të zakonshëm që kanë ditur të jetojnë jetën e tyre me guxim për të arritur triumfin e drejtësisë dhe respektit për më të dobtit.

Aktivitetet që do të zhvillohen në Kampusin ZKM do të nisin të premten më datë **6 mars 2026** në ditën Evropiane të Të Drejtëve me një koncert me këngë në Kopshtin e Të Drejtëve. Më pas të mërkurën më datë **11 mars** ku do zbulohet në Kopshtin tonë guri me emrin e gdhendur të Të Drejtët të zgjedhur për vitin 2026. Do të përkujtojmë të hënën më datë **16 mars** në ndarjen nga jeta të mjekut fr. Emanuele Stabulum "i Drejtë mes Kombeve" dhe së fundmi, të enjten më datë **19 mars** do të kremtojmë Meshën në Kishën e Spitalit për festën e Shën Jozefit, i cili ishte "një njeri i drejtë" (Mateu 1,19). Këto episode festimesh modeste do të jenë momente të shkurtra, por të gjalla për të zgjuar më të mirën brenda secilit prej nesh. Në posterin ngjitur gjenden oraret e organizimeve.



luftërat e reja në zhvillim. Shumë njerëz janë si të paralizuar dhe nuk duan të kuptojnë detyrën e tyre ndaj përgjegjësisë.

Sot shohim me shqetësim të madh se autokratët dhe sundimtarët imponojnë ligjin e më të fortit dhe minojnë demokracinë dhe të drejtën ndërkombëtare.

Duket se nuk po lind një elitë e re morale në botë që mund bëjë thirrje të besueshme për rezistencë dhe përpjekje për të ndryshuar rrjedhën e ngjarjeve.

Nga Irani në Turqi, nga Gaza në Izrael, nga Rusia në Ukrainë, Të Drejtët duket se janë të mundur kudo.



KUJTESA E TOTALITARIZMIT NË EVROPË

Një libër në Bibliotekë



Libri me titull “Për të mos harruar” – Kujtesa e Totalitarizmit në Evropë u botua si rezultat i një projekti të përbashkët që ka përfshirë institucione dhe organizata, të cilat bashkëpunojnë në kuadër të Platformës për Kujtesën dhe Ndërgjegjen Evropiane – Platform of the European Memory and Conscience. Qëllimi i projektit ishte botimi i një libri që do të zgjonte sërish interesin e të rinjve të sotëm evropianë për të kaluarën e afërt të kontinentit, të një Evrope që deri vetëm një brez më parë ishte ndarë me forcë.

Për këtë arsye pjesëmarrësit zgjodhën të rrëfejnë 30 histori të jashtëzakonshme jetësore të burrave dhe grave të goditur nga totalitarizmi, me prejardhje nga 16 vende të ndryshme. Në libër rrëfohen përvojat e njerëzve të guximshëm që u ngritën kundër sistemeve të pushtetit totalitar. Histori fëmijësh, studentësh dhe të rriturish, grash dhe burrash, fermerësh, punëtorësh, mësuesish, mjekësh, inxhinierësh, shkrimtarësh, artistësh, politikanësh, ushtarësh, anëtarësh të Rezistencës dhe klerit. Histori që pasqyrojnë dashurinë për lirinë, dinjitetin njerëzor, rezistencën, guximin, besimin dhe respektin e lartë për vlerat themelore njerëzore. Prezantimet e shkurtra në këtë botim për secilin vend ndihmojnë studentët të lidhin ngjarjet e rrëfyera me kontekstin historik që i shoqëron. Info-Box-et, tabelat e përmbledhura në tekst sqarojnë disa fakte dhe tema me interes të përgjithshëm.

Libri që gjendet në Bibliotekën ZKM i dedikohet kujtesës së miliona e miliona evropianëve të pafajshëm, të cilëve totalitarizmi u mori jetën, si atyre që luftuan në radhët e Rezistencës dhe atyre që luftuan për ndërtimin e një shoqërie të lirë dhe demokratike. Kujtesa lidhet me kuptimin e së kaluarës ndërsa përgjegjësia është gjithmonë e lidhur me të tashmen.

FËMIJËT E THERESIENSTADT

Victor Frankl shpikësi i logoterapisë dhe i mbijetuar i Auschwitz-it pasi kishte humbur të gjithë të dashurit e tij nga shfarosja në kamp shkruante se ata që kishin arritur të ruanin kuptimin e jetës edhe në situata pa shpresë, duhej të konsideroheshin fitues moralë pavarësisht rezultatit të betejave të tyre dhe vetë mbijetesës.

Duke rrëfyer historinë një mijë fëmijëve nga Getoja e Theresienstadt në Auschwitz, Frankl mbështeste idenë se ata kishin triumfuar mbi të keqen. Fëmijët një natë përpara tragjedisë

kishin marrë me vete fshehurazi libra nga biblioteka.

Si ishte e mundur?

Me ato libra në duar ata ishin më të fortë se Hitleri sepse kishin shpëtuar idenë e tyre për humanitetin dhe pastaj me sakrificën e tyre kishin mbajtur ndezur shpresën për të ardhmen që do të përqafohej nga brezat pasardhës. Rezistenca e tyre nuk kishte qenë e kotë.

Sot duke parë shtypjen e pafundme në Rusi, luftën pa fund midis izraelitëve dhe

palestinezëve, masakrat në Iran mund të na pushtojë dëshpërimi duke menduar se pafuqia sundon mbi njerëzit. Por nuk është kështu. Duke mbrojtur kuptimin e jetës ata gra dhe burra të guximshëm na japin mundësinë të rindërtojmë të ardhmen.

Prandaj është detyra jonë t'i kujtojmë në këto kopshte Të Drejtët e kohës sonë. (Gabriele Nissim, themelues i Kopshtit të Të Drejtëve të Milano/Gariwo).

MIRË SE VINI MIQ INDIANË!

PËR NJË UNIVERSITET...UNIVERSAL

Këtë vit akademik Universiteti Zoja e Këshillit të Mirë iu bashkuan 130 të rinj indianë, të cilët do të arsimohen në shëndetësi. Ata janë regjistruar për kualifikimin "OSS – Asistent Social Shëndetësor" në degën e Elbasanit dhe atë të Shkodrës. Të rinjtë janë regjistruar gjithashtu në programin Bachelor në Infermieri dhe në programin Master Shkencor në Mjekësi dhe Kirurgji në Tiranë.

Një grup studentësh dhe studentesh, të cilët tashmë janë diplomuar në infermieri në vendin e tyre po ndjekin disa muaj kurse gjuhësore në Elbasan me qëllim që më pas të integrohen në strukturat shëndetësore në Itali.

Kjo risi e këtij viti pasuron Kampusin me kultura të reja pas pranisë tashmë të konsoliduar të qindra studentëve nga Italia dhe disa prej tyre nga vendet e Ballkanit. Në këtë iniciativë kanë qenë shumë të angazhuar Atë Benny dhe




Atë Anish duke i mirëpritur të sapoardhurit me ngrohtësi dhe mbështetje. Një falënderim shkon për disa organizata fetare që kanë vënë në dispozicion strukturat e tyre akomoduese: në Shkodër

Seminari Ndërdioqezan dhe shtëpia e Motrave të së Lumes Eugenia Ravasco. Në Elbasan janë Motrat e Shën Antida Thouret dhe Motrat Orionine.

KRESHMA

KOHË PËR TË
NDRYSHUAR
MENDËSINË



Në traditën e besimit të krishterë jetohej edhe një periudhë që quhet

"Kreshma", e cila paraprin Pashkët. Bëhet fjalë për një periudhë dyzet ditore gjatë së cilës besimtari përkushtohet në mesazhin e Jezusit dhe përpiqet të përshtatë stilin e tij të jetës sipas modelit të Tij. Gjatë Kreshmës është traditë e rrënjësuar thellë kremtimi i "Via Crucis" (Udha e Kryqit) për të medituar mbi Agoninë/Pasionin/Dhimbjen/Vuajtjen e Krishtit, i cili mori mbi vete dhimbjet dhe vuajtjet e njerëzimit.

Ne ju ofrojmë një libër me shkrimet e Emanuele Stabulum, i cili ka jetuar jetën e tij si një njeri i kushtuar dhe si mjek. Për ata që dëshirojnë të mësojnë më shumë edhe për meditimin e tyre, libri është i disponueshëm falas në bibliotekën tonë ose tek Atë Paschal.



SHKURTI MES AUDITORËVE DHE ZEMRAVE

Mes heshtjes dhe lulëzimit, dijenia zgjohet dhe dashuria merr formë.

Shkurti, ky muaj në prag mes dimrit dhe pranverës, hyn në universitet me gjithë luhajtjet e tij të motit herë i veshur me shi e mjegull, herë i çelur nga rrezet e buta të diellit.

Mbi fletët e kalendarit ende ndihet freskia e ngricës së dimrit, ndërsa në frymën e studentëve shpërthen ngadalë pranvera.

Kudo që hedh sytë në korpusin universitar, vëren një ndryshim të heshtur, por domethënës.

Duket sikur shkurti, i vetëdijshëm për padrejtësinë e të qenit më i shkurtër se muajt e tjerë, kërkon të kompensojë kohën duke na ftuar në reflektim.

Ai bëhet një muaj sprove, një urë kalimi nga një periudhë gati-letargjike drejt një zgjimi intelektual e emocional.

Dhe pyetja mbetet:

sa gati jemi për këtë zgjim?

Në kampusin tonë, që duket sikur njeh vetëm një stinë, pranverën e përhershme gjithçka gjallëron. Cicërima zogjsh, gjelbërim, stola të mbushura me çifte që shkëmbejnë buzëqeshje, grupe studentësh që ndajnë kohë, ide dhe ushqim, korridore plot zëra, shënime e shpresa.

Pranë gjithë këtij gjallërimi qëndron biblioteka një tempull i heshtur i dijes.

Sa tensione, ankth, lot, zhgënjime, por edhe triumfe, ëndrra dhe arritje ka dëshmuar ajo! Në raftet e saj ruhen jo vetëm libra, por

edhe gjurmët e brezave që kanë kaluar: nënvizime të nxituara, shënime motivuese, mesazhe të fshehta për ata që do të vijnë më pas. Sidomos gjatë shkurtit dhe qershorit, kur dija vihet në provë, biblioteka bëhet zemra që rreh më fort.

Këto ditë, studentët kanë pushtuar sërish hapësirat e korpusit, por ecin ndryshe: me libra nën sqetull, laptop në çantë, kafe në dorë dhe mendime që luhaten mes provimeve dhe ndjenjave.

Pranvera brenda tyre zgjon pasionet, dëshirat dhe ëndrrat,

në respektin ndaj studentëve, në pasionin për profesionin.

Dashuria bëhet urë komunikimi, solidariteti dhe mirëkuptimi mes brezave.

Biblioteka mbetet dëshmitare e miqësive të lindura, ëndrrave të para, lidhjeve që fillojnë platonike e ndonjëherë shndërrohen në familje, si dhe rikthimeve nostalgjike të atyre që u formuan aty me një tjetër status.

Shkurti në universitet nuk është vetëm muaji i dashurisë romantike.

Është muaji i dashurisë për dijen, librin, fjalën e bukur dhe të vërtetën.

Është dashuria për të ardhmen që ndërtohet në këto mure, në këto banka, në këto mendje të reja.


Dita nis me muzikën e shpirtit, me pritje, të qeshura, ndonjëherë edhe lotë.

Dështimet ndodhin, por mbeten veç një ndalesë, jo një fund, sepse studentët e dinë se

mossuksesit në provim nuk është dështim si njeri, por një mësim për të ecur më i fortë përpara.

Kështu është shkurti në universitet: i shkurtër në kalendar, por i gjatë në ndjenjë; një stinë ku dimri takon pranverën dhe ku dija përqafohet me dashurinë.

nga
Mimoza Agastra
Përgjegjëse
e Bibliotekës
'Fr. Paolo Ruatti'
UKZKM



ndërsa shkurti i thërret drejt përqendrimit dhe seriozitetit. Mes këtyre dy poleve dashurisë dhe përgjegjësisë ata rriten.

Diku dikush pret një mesazh. Diku tjetër vidhet një shikim. Dikush guxon të dashurojë për herë të parë; diku tjetër mbetet një puthje e fshehtë, një letër e harruar mes faqesh, një fjali që bëhet kujtim.

Dashuria nuk figuron në programet mësimore, por mësohet çdo ditë: në mënyrën si profesorët transmetojnë dijen,



Të gjithë e kemi dëgjuar dhe lexuar këtë tekst prekës të Shën Lukës (khs. Lk 10,25-37). Një mësues i Ligjit e pyet Jezusin se kush është i afërmi që duhet dashur dhe Jezusi i përgjigjet duke treguar një histori: një njeri që udhëtonte nga Jerusalemi në Jerihon u sulmua nga hajdutët dhe u la gjysmë i vdekur; një prift dhe një levit kaluan pranë tij, por vetëm samaritani pati dhembshuri për të, ia lidhi plagët, e çoi në një bujtinë dhe pagoi që të kujdeseshin për të. Kam dashur të propozoj një reflektim mbi këtë fragment biblik në dritën hermeneutike të Enciklikës Fratelli Tutti të paraardhësit tim të dashur, Papa Françeskut, ku dhembshuria dhe mëshira ndaj nevojtarit nuk reduktohen në një përpjekje thjesht individuale, por realizohen në marrëdhënie: me vëllain në nevojë, me ata që kujdesen për të dhe në themel, me Hyjin, i cili na dhuron dashurinë e Tij.

1. Dhurata e takimit: gëzimi i dhënies së afërsisë dhe pranisë

Ne jetojmë të zhytur në kulturën e shpejtësisë, të gjërave të menjëhershme dhe të ngutjes, por edhe të përjashtimit dhe të indiferencës që na pengon të

shmang”, por e vështroi me sy të kujdesshëm, si vështrimi i Jezusit, i cili e çoi drejt një afërsie njerëzore dhe solidarë. Samaritani « u ndal, i dhuroi afërsi, e mjekoi me duart e veta, pagoi nga xhepi i tij dhe u kujdes për të. Mbi të gjitha, i dhuroi [...] kohën e vet». Jezusi nuk mëson kush është i afërmi, por si të bëhemi të afërm, domethënë si të bëhemi ne vetë të afërt.(...). Dashuria nuk është pasive, ajo shkon drejt tjetrit. Të jesh i afërm nuk varet nga afërsia fizike apo shoqërore, por nga vendimi për të dashur.

Prandaj i krishteri bëhet i afërm për atë që vuan duke ndjekur shembullin e Krishtit, Samaritanit të vërtetë hyjnor, i cili iu afrua njerëzimit të plagosur. Nuk bëhet fjalë për gjeste të thjeshta filantropie, por për shenja në të cilat mund të dallohet se pjesëmarrja personale në vuajtjet e tjetrit përfshin dhurimin e vetvetes.

Kjo do të thotë të shkohet përtej përmbushjes së nevojave derisa vetë personi të bëhet pjesë e dhuratës. Kjo dashuri ushqehet domosdoshmërisht nga takimi me Krishtin, i cili për dashuri u dhurua për ne. Shën Françesku e shpjegonte shumë mirë këtë kur



Një dritare e pikturuar kushtuar Samaritanit të Mirë e vendosur në kishëzën e Spitalit Katolik Zoja e Këshillit të Mirë, Tiranë

afrohemi e të ndalemi përgjatë udhës për të parë nevojat dhe vuajtjet që na rrethojnë. Shëmbëlltyra tregon se samaritani kur e pa të plagosurin nuk “u

duke folur për takimin e tij me lebrozët thoshte: «Vetë Zoti më çoi mes tyre», sepse pikërisht përmes tyre kishte zbuluar ëmbëlsinë e gëzueshme të dashurisë. (...)

2. Misioni i përbashkët në kujdesin ndaj të sëmurëve

Shën Luka vazhdon duke thënë se samaritani "pati dhembshuri për të". Të kesh dhembshuri nënkupton një ndjenjë të thellë të zemrës që shtyn drejt veprimit. Është një ndjenjë që buron nga brendia dhe çon në angazhim përballë vuajtjes së tjetrit. Në këtë



shëmbëlltë, dhembshuria është tipari dallues i dashurisë vepruese. Ajo nuk është as teorike as thjesht sentimentale, por përkthehet në gjeste konkrete: samaritani afrohet, i mjekon plagët, merr përgjegjësi dhe kujdeset për të. Por kujdes, ai nuk vepron i vetëm, në mënyrë individualiste. «Samaritani kërkoi një bujtinar që të mund të kujdesej për atë njeri, ashtu si edhe ne jemi të thirrur të ftojmë dhe të takohemi në një që bëhet më i fortë se shumë individualitete të vogla». (...)

Familjarët, fqinjët, punonjësit shëndetësorë, ata që janë të angazhuar në baritoren shëndetësore dhe shumë të tjerë që ndalen, afrohen, mjekojnë, bartin, shoqërojnë dhe ofrojnë atë që kanë i japin dhembshurisë një përmasë shoqërore. Kjo përvojë që realizohet në një ndërthurje marrëdhëniesh e tejkalon angazhimin thjesht individual. (...)

3. Të shtyrë gjithmonë nga dashuria për Hyjin, për t'u takuar me vetveten dhe me vëllain

Në urdhërimin e dyfishtë: « Duaje Zotin, Hyjin tënd, me gjithë zemrën

tënde, me gjithë shpirtin tënd, me gjithë fuqinë tënde, dhe me gjithë mendjen tënde edhe 'të afërmin tënd porsì vetveten» (Lk 10,27) mund të dallojmë parësinë e dashurisë për Hyjin dhe pasojën e drejtpërdrejtë që ajo ka mbi mënyrën e të dashurit dhe të të jetuarit të marrëdhënieve të njeriut në të gjitha përmasat e tij.

« Dashuria për të afërmin është prova e prekshme e vërtetësisë së dashurisë për Hyjin, siç dëshmon Gjoni apostull: "Hyjin askurrë askush nuk e pa. Nëse e duam njëri-tjetrin Hyji mbetet në ne dhe dashuria e tij në ne është e përkryer. [...] Hyji është Dashuri dhe kush mbetet në dashuri, mbetet në Hyjin dhe Hyji mbetet në të" (Gjon 4,12.16)».

Megjithëse objekti i kësaj dashurie është i ndryshëm: Hyji, i afërmi dhe vetvetja, dhe në këtë kuptim mund të flasim për dashuri të dallueshme, ato janë gjithmonë të pandara. Parësia e dashurisë hyjnore nënkupton që veprimi i njeriut të mos kryhet për interes vetjak apo për shpërblim, por si shfaqje e një dashurie që i tejkalon normat rituale dhe përkthehet në një kult të vërtetë: t'i shërbesh të afërmit do të thotë ta duash Hyjin me vepra. Kjo përmasë na lejon gjithashtu të kuptojmë çfarë do të thotë ta duam vetveten. Do të thotë të largojmë prej nesh tundimin për ta themeluar vetëvlerësimin apo ndjenjën e dinjitetit tonë mbi stereotipe suksesi, karriere, pozite apo prejardhjeje dhe ta rifitojmë vendosjen tonë të vërtetë përpara Hyjit dhe vëllait. Benedikti XVI thoshte se «krijesa njerëzore, si

natyrë shpirtërore, realizohet në marrëdhëniet ndërpersonale. Sa më shumë i jeton ato në mënyrë autentike aq më shumë piqet edhe identiteti i tij personal. Njeriu nuk e vlerëson veten duke u izoluar, por duke hyrë në marrëdhënie me të tjerët dhe me Hyjin».

Të dashur vëllezër e motra, «ilaçi i vërtetë për plagët e njerëzimit është një stil jete i bazuar në dashurinë vëllazërore, i cili e ka rrënjën në dashurinë e Hyjit ». Dëshiroj me gjithë zemër që në stilin tonë të jetës së krishterë të mos mungojë kurrë kjo përmasë vëllazërore, "samaritane", gjithëpërfshirëse, e guximshme, e angazhuar dhe solidare, që e ka burimin e vet më të thellë në bashkimin tonë me Hyjin dhe në besimin në Jezun Krishtin. Të ndezur nga kjo dashuri hyjnore, do të mund të dhurohemi me të vërtetë për të mirën e të gjithë atyre që vuajnë, sidomos të vëllezërve tanë të sëmurë, të moshuar dhe të pikëlluar.

Le ta ngremë lutjen tonë drejt së Lumes Virgjër Mari, Shëndeti i të Sëmurëve; ta kërkojmë ndihmën e saj për të gjithë ata që vuajnë, që kanë nevojë për dhembshuri, dëgjim dhe ngushëllim, dhe t'i lutemi ndërmjetësimin të saj me këtë lutje të lashtë, e cila recitohej në familje për ata që jetojnë në sëmundje dhe në dhimbje:

Nënë e ëmbël, mos u largo,
mos e largo prej meje shikimin tënd.

Eja me mua kudo
dhe mos më lër kurrë vetëm.

Ti që gjithmonë më mbron
si Nëna ime e vërtetë,
bëj që të më bekojë Ati,
Biri dhe Shpirti Shenjt.

Me gjithë zemër jap Bekimin tim Apostolik për të gjithë të sëmurët, për familjarët e tyre dhe për ata që kujdesen për ta, për punonjësit shëndetësorë, për personat e angazhuar në baritoren shëndetësore dhe, në mënyrë të veçantë, për ata që marrin pjesë në këtë Ditë Botërore të të Sëmurit.

LEONI PP. XIV

TAKIMET E ARDHSHME

PREMIO CESPIC PER LA PACE



1^a edizione

ORE **10:00**

Aula Magna



FONDAZIONE
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO
Tirana
Dedicata all'educazione, dedicata alla salute

11 Marzo 2026

Università Cattolica
"Nostra Signora del Buon Consiglio", Tirana

GIARDINO
DEI GIUSTI



PROCLAMAZIONE del GIUSTO

3^a edizione

eletto con votazione pubblica

ORE **12:00**

Giardino
dei Giusti

SUMMER SCHOOL

11th EDITION

Roots of War
and Establishment
of a Lasting Peace



CATHOLIC UNIVERSITY
OUR LADY OF GOOD COUNSEL



European Centre
of Peace Science
Integration and Cooperation

31 Aug - 8 Sept 2026

PICCOLO SPAZIO
PROMOZIONALE



la salute ad un passo!

Carta Salute per gli Studenti dell'Università Cattolica
"Nostra Signora del Buon Consiglio" con **SCONTI DEDICATI** sui
servizi medici dell'Ospedale Cattolico Nostra Signora del Buon Consiglio.



UNIVERSITETI KATOLIK
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË



Spitali Katolik
Zoja e Këshillit të Mirë

Përkushtuar Shëndetit Tënd




FONDAZIONE
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO
Tirana
Dedicata all'educazione, dedicata alla salute

 **GIARDINO
DEI GIUSTI**
TIRANA

VIVERE **GIUSTI** PER ESSERE VERI

6-19
marzo
2026



VENERDÌ 6

ore
13

**GIORNATA
EUROPEA
DEI GIUSTI**

Nel giardino dei Giusti:
inCANTO di speranza
(con il coro dell'Università)



MERCOLEDÌ 11

ore
12

**UN
GIUSTO
PER NOI**

Scoprimento del cippo
con il nome
del Giusto 2026



LUNEDÌ 16

ore
16:30

**ANNIVERSARIO
DELLA MORTE
DI EMANUELE
STABLUM**

In **Casa Rossa**:
La storia di un medico
"Giusto tra le Nazioni"



GIOVEDÌ 19

ore
08:30

**SAN GIUSEPPE:
"UOMO GIUSTO"**

Nella cappella dell'Ospedale:
Santa Messa

KOHA PËR RREGULLA

PARKIMI NË KAMPUS

Gjatë javëve të ardhshme në Kampusin ZKM do të aktivizohet **një rregullore për menaxhimin e parkimit.**

Rritja e vazhdueshme e numrit të automjeteve e ka shndërruar këtë hapësirë në zonë kaotike dhe kjo situatë nuk mund të tolerohet më.

Nevoja për të rregulluar fluksin e mjeteve dhe rregullin në Kampus kërkon kontroll më të madh në hyrje dhe në dalje, gjë që në shumë institucione dhe zona urbane zgjidhet **përmes pagesës.**

Tarifat që do të aplikohen në javët në vijim do të jenë më të ulëta se mesatarja e parkimeve në qytet dhe të ardhurat prej tyre do të shkojnë për menaxhimin, mirëmbajtjen e strukturave dhe pastrimin e parkimit.

Hyrja e automjeteve do të autorizohet vetëm në varësi të vendeve të lira. Menaxhimi i është besuar shoqërisë që aktualisht kryen shërbimin e ruajtjes së të gjithë Kampusit.

Fondacioni ZKM kërkon bashkëpunimin e të gjithëve që parkimi të jetë një shërbim i mirëmenaxhuar dhe i rregulluar, duke siguruar edhe rregull në zonat e përcaktuara.



**FONDACIONI
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË**

Përkushtuar edukimit, përkushtuar shëndetit



**RESPEKTO
TROTUARIN!**

**RESPEKTO
VIJAT E BARDHA!**

